



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Agro Invest shpk" të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHE**t kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Agro Invest shpk" të datës 05.01.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHE**t autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHE**n palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Agro Invest shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 05.01.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtuesit: **"PRETENDIMI 1:** AK eliminon ofertën tonë mbi të njëjtat arsye si në Vendimin e datës 10.06.2025 përkundër se ankesa jonë ishte aprovuar si pjesërisht e bazuar nga OSHP nëpërmjet Vendimit OSHP: 2025/0560. Përkundër këtyre gjetjeve të Panelit Shqyrtues, AK përsëri eliminon ofertën tonë mbi arsyet identike si dhe në kundërshtim të plotë me vendimin e OSHP-së përsëri rekomandon për kontratë GOE DIGA Solutions; ED-Construction SH.P.K.; Industria Metalike e Kosovës SH.P.K.

PRETENDIMI 2: GOE i rekomanduar është i papërgjegjshëm. Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet Vendimit OSHP: 2025/0535 dhe 2025/0560 ka konstatuar se oferta e GOE DIGA Solutions; ED-Construction SH.P.K.; Industria Metalike e Kosovës SH.P.K. është e papërgjegjshme dhe se përgjegjshmëria e kësaj oferte nuk mund të korrigjohet me rivlerësim.

PRETENDIMI 3: AK duhet të anulohet në tërësi aktivitetin e prokurimit. Nëpërmjet Vendimit OSHP: 2025/0535 dhe 2025/0560, përkatësisht arsyetimit të vendimit në fjalë është konstatuar se asnjëri nga OE-të nuk është i përgjegjshëm, prandaj gjatë rivlerësimit AK do të duhej të anulonte në tërësi këtë aktivitet në mënyrë që të ruhet ligjshmëria dhe integriteti në këtë aktivitet të prokurimit. Çdo veprim tjetër do të përbënte shkelje të rëndë të LPP. Konkretisht papërgjegjshmëria e operatorëve konkurrues në këtë aktivitet të prokurimit qëndron aty se:

1. GOE i rekomanduar është i papërgjegjshëm mbi arsyet e elaboruara në pretendimin numër 2.
2. GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K. është i papërgjegjshëm për faktin se si i tillë është shpallë me Njoftimin mbi Vendimin e AK të dt. 10.06.2025 dhe nuk e ka kundërshtuar këtë vendim.
3. GOE EING COM SH.P.K.; MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI A.S. është i papërgjegjshëm për:
 - Në vend të tubave PP dhe PE janë ofruar materiale PVC (standard) dhe PU (opsional).
 - Lidhjet dhe ventilat, në vend të STORZ 110A ofron ASTM Z dhe ASTM Universal ë është në shpërputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.
 - Dokumentacioni i ofertës nuk dëshmon ofrim konkret të tubave me gjatësi 100m dhe 200m sipas DT.
4. AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Beaver Schutzsysteme AG; LORG GROUP SH.P.K.; Ermal Sylaj B.I. është i papërgjegjshëm sepse sipas vendimit të OSHP-së:
 - Katalogu i ofruar është në gjuhën gjermane dhe nuk është i përkthyer në tërësi.
 - Nuk është paraqitur dëshmi që tubat e ofertuar janë të prodhuar nga PE ose PP.
 - Nuk është paraqitur dëshmi se tubat e ofertuar përfshijnë ventila të standardit të kërkuar 4" Storz 110A".

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtuesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

-Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numer tre (3) në FDT-Katalogu është në gjuhën gjermane dhe nuk përputhet me katalogun në faqen e internetit (website) të prodhuesit ku nuk i plotësoni kërkesat e kërkuara.

-Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbush kërkesat sipas kriterit të DT-së ku :

Te materialet: përdorë PVC, nuk i përmbush kërkesat e tenderit që kërkojnë materialet PP dhe PE. PVC është i përdorur gjerësisht për barrierat e përmblyjeve, por mund të ketë më pak fleksibilitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë në kushte ekstreme, krahasuar me PP dhe PE.

-Lidhjet dhe Ventilat: ofron Storz 55, që është një tjetër mangësi e rëndësishme, pasi kërkesat specifike në tender është për STORZ 110A, që ka një diametër më të madh dhe është standardi më i përdorur për sisteme të tilla. Kjo mund të shkaktojë vështirësi për t'u lidhur me pajisje të tjera dhe mund të ndikojë në efikasitetin e sistemit.

-Pikat Mbushëse: Nuk janë dhënë detaje të plota për pikat mbushëse, por është e mundur që pikat të lidhen në mënyrë të centralizuar, siç kërkohet, duke siguruar mbushjen e sistemit me ujë në një pikë të vetme.

-Gjatësia e Seksioneve: ofron seksione vetëm deri në 20 metra,.

Ne DT kërkohet që seksionet të jenë 100 dhe 200 metra të gjata për shkak të përshtatjeve në terrene të ndryshme, stabilitetit, qëndrueshmërisë ndaj presionit.

-Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër katër (4) mungon Certifikatës e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore.

-Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër pesë(5) raporti vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet nuk është i vëltur.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Pra oferta e tenderuesit të rekomanduar është oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Vlen të shtohet fakti që lidhur me këtë aktivitet të prokurimit deri më tani ekzistojnë dy (2) vendime të OSHP (2025/0535 dhe 2025/0560). Sipas këtyre vendimeve të OSHP parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Ky fakt nuk është kontestues as vet parashtruesin i cili e konfirmon (e pranon) që ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Në këtë formë e shpallë vetën e tij edhe si palë pa interes në kuptim të nenin 4 par. 1.26 të LPP pasi që nuk mund të dëshmojë më tutje asnjë interes material nga ky aktivitet i prokurimit për të cilin ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.01.2026

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.